



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AOME SHPK" të datës 16.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me dru per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkesit lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5474-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AOME SHPK" të datës 16.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me dru per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkesit lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5474-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AOME SHPK" (tutje "parashtruesi") me datë 16.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me dru per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te, bashkesit lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5474-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Pretendimi 1:

Shkelje e nenit 6 të LPP - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti.

Ju e keni shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik "Berveniku Corporation" SHPK me ofertë prej 136.000,00 Euro e cila është mbi dyfish më e lartë se oferta e jonë prej 59.333,00 Euro.

Sipas nenit 6 të LPP "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit".

Ju e keni shkelur këtë nen të ligjit në mënyrë drastike duke e shpërblyer me kontratë ofertën e cila i ka çmimet mbi dyfish më të larta se oferta e jonë por edhe që ka ofruar çmime dukshëm më të larta se çmimet aktuale të tregut.

Pretendimi 2:

Shkelje e nenit 61 të LPP - Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, si arsye për eliminimin tonë ju keni shkruar si në vijim:

"Keni ofruar, ofertën me çmimin Jo normalisht të ulët me çmimin e ofruar pre 59,330.00 Euro. Por nuk ka arritur të bind komisionin e vlerësimit për çmimin Jo normalisht të ulët"

Me këtë, ju keni vepruar plotësisht në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, përkatësisht keni vepruar në kundërshtim me trajtimin e çmimit Jo-normalisht të ulët sipas nenit 61 të LPP, dhe atë për këto arsye:

- Me kërkesën tuaj ne ju kemi dërguar një shkresë me të gjitha arsyet bindëse lidhur me çmimin tonë të ofruar. Ne ju kemi ofruar të gjitha faturat origjinale të furnizimit së bashku me dëshmitë e transaksioneve bankare, të cilat qëllimisht nuk janë marrë parasysh nga ju dhe komisioni i vlerësimit.
- Ne ju kemi shpjeguar se furnizimi me lëndë drusore nuk është projekt kompleks dhe nuk ka ndonjë proces të ndërlikuar të prodhimit, prandaj çmimi i furnizimit duke i shtuar një marzh të fitimit ju është ofruar juve i cili do të duhet pranuar.
- Ju dhe as Komisioni i vlerësimit nuk na keni ofruar sqarimet e nevojshme pse oferta e jonë nuk është pranuar, përveq deklaratës se komisioni "nuk është bindur" e cila jo vetëm që është e pamjaftueshme por është jo-ligjore dhe madje skandaloze.
- Me një analizë të thjeshtë dhe një hulumtim të tregut, çmimi i druve prej 80 Euro për metër është çmim që e tejkalon dukshëm edhe furnizimin me pakicë e lëre furnizimin me shumicë. Andaj refuzimi i ofertës tonë të përgjegjshme dhe pranimi i një oferte me çmim dyfish më të lartë është jo vetëm keqpërdorim i parësë publike por edhe veprim korruptiv.
- Edhe pse ne kemi kërkuar, ju nuk na keni ofruar raportin e vlerësimit të komisionit duke mos na dhënë qasje të plotë se pse komisioni nuk është bindur me sqarimet e tona për çmimin e ofruar, çka përbën fshihje dhe jotransparencë të plotë
- Në zbatim të nenit 61 të LPP, ju nuk e keni njoftuar KRPP-në lidhur me eliminimin tonë sepse gjatë qasjes në dokumente ju nuk na keni ofruar dëshmi se e keni njoftuar KRPP-në.

Pretendimi 3:

Shkelje e nenit 30 të Rregullorës për Prokurim Publik – Validiteti i tenderit.

Në dosjen e tenderit, ju keni kërkuar që periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë 60 ditë (edhe pse në kundërshtim me LPP, sepse për vlera të mëdha kjo kërkesë do të duhej të ishte 90 ditë!).

Kjo vlefshmëri e tenderit ka skaduar me datën 09.09.2025 duke qenë se hapja e tenderëve

është bërë me datën 10.07.2025, dhe ju e keni vonuar vlerësimin e tenderit mbi periudhën prej 30 ditëve në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Ansijë arsye nuk keni ofruar për një vonesë të tillë të procesit të vlerësimit.

Duke qenë se ju nuk keni kërkuar zgjatje të validitetit të tenderit, në me datën 10.09.2025 e kemi ofruar në eProkurim zgjatjen e validitetit së bashku me sigurimin e ofertës të zgjatur konform rregullave të prokurimit.

Në takimin për qasje në dokumente të tenderit, ju nuk na keni ofruar fakte se kërkuar OE të propozuar për kontratë i keni kërkuar zgjatje të validitetit dhe nuk na keni ofruar dëshmi ky OE e ka dorëzuar deklaratën për zgjatje të validitetit së bashku me sigurimin e ofertës të zgjatur.

Me datën 11.09.2025, ju keni publikuar Njoftimin për vendimin e AK-së pa validitet të zgjatur të ofertës situase duke bërë shkelje të rëndë të Lidhit dhe të rregullave të prokurimit.

Në lidhje me validitetin e tenderit ka një interpretim ligjor nga KRPP i cili thotë si në vijim – (shiko interpretimi i KRPP-së numër 7, i datës 22.11.2022):

Neni 30.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, kërkon rreptësisht që oferta të ketë validitet deri të dhënia dhe nënshkrimi i kontratës. Prandaj KRPP konsideron se asnjë kontratë publike nuk mund të nënshkruhet me validitet të skaduar të ofertës. Për këtë arsye, Zyrtori Përgjegjës i Prokurimit duhet me kujdesin më të madh të përcjellë validitetin e ofertave, dhe në çdo rast duhet të kërkojë nga të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës zgjatjen e validitetit të ofertave para datës së skadimit. Në mënyrë retroaktive nuk mund të kërkohej zgjatja e validitetit të ofertave dhe/ose e sigurisë së tenderit. KRPP do të monitorojë me kujdes të veçantë autoritetet kontraktuese për moszbatimin e nenit 30.4 të Rregullores për Prokurimin Publik. Mos zbatimin i nenit 30.4 klasifikohet si shkelje e rëndë sipas nenit 97 të kësaj rregulloreje, andaj KRPP do të ndërmarr masa në përputhje me nenin 97 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Prendimi 4:

Ka marrëveshje të fshehtë për kurdasje të çmimit dhe dorëzim i 4 (katër) ofertave me pronarë të njëjtë.

Kjo është shkelja më e rëndë që është bërë në këtë tender sapse është lejuar që të vlerësohen ofertat e katër kompanive që kanë pronarë të njëjtë. Kjo i bie që një pronar ka dorëzuar katër oferta për të njëjtin tender.

Sipas të dhënave në regjistrat e ARBK-së shihet qartë se Avni Murtezi dhe Bedri Murtezi janë bashkëpronar ose pronar të vetëm në këto katër firma: 1. Berveniku Corporation, 2. AM&BM shpk, 3. Avni Murtezi B.I. dhe 4. Nazi Travel.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtuesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsyet si në vijim:

ARSYETIM

Ju njoftojmë se oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsye:

Juve ju është kërkuar sqarime për çmim Jo normalisht të ulët me datën 18.08.2025, komfort nenit 61 të LPP-së, dhe Nenit 41.3 ose 41.4 të Rregullores P.P.P Nr. 001/2022.

Ju me datën 19.08.2025 keni dërguar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar sqarimet e dërguara nga ana juaj dhe ka konstatuar se për pozicionet 1, të kërkesave të Autoritetit Kontraktues për AK-në janë të pa pranueshme, përgjigjet e juaja lidhur me sqarimet e kërkuara nuk janë të argumentuara as bindëse për AK-në.

Keni ofruar, ofertën me çmimin Jo normalisht të ultë me çmimin e ofruar prej 59,330.00 Euro.

Por nuk ka arritur të bind komisionin e vlerësimit me sqarimet e dërguara për çmimin Jo normalisht të ulët. Dhe për këtë arsyeje jeni eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuar në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj të gjitha pretendimet ankimore janë gjetur si të pabazuara ashtu që kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.